

Prof.Asoc.Dr. Nada Kallçiu

Nada Kallçiu është pedagoge me kohë të plotë në Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës prej vitit 2004. Studimet e larta i ka kryer në Universitetin e Padovës Itali në degën Shkenca Edukimi dhe më pas ka vazhduar studimet master në Universitetin e Venecias Itali në “Menaxhim projektesh në fushën e edukimit për Europën qendrore dhe Ballkanin”. Zotëron titullin akademik “Profesor i Asociuar” në fushën e edukimit nga Universiteti i Tiranës.

Ka qenë pjesë e ekipeve kërkimore për kërkime të përbashkëta me Universitetin Pedagogjik të Zyriut, Zvicër mbi kulturën e të nxënit në arsimin e lartë dhe me Universitetin e Lozanës Zvicër për standartizimit e instrumenteve të matjes për orientimin në karrierë. Ajo është koordinatore e projektit të përbashkët me Universitetin e Lozanës për ngritjen e kapaciteteve dhe infrastrukturës për orientimin e karrierës në vend. Gjithashtu, ka eksperiencë mësimit edhe në universitete evropiane.

Ka marrë pjesë në aktivitete të shumta ndërkombëtare lidhur me arsimin dhe orientimin profesional, si: politikat arsimore, menaxhimi dhe administrimi në arsim, sigurimi i cilësisë, planifikimi, matja dhe vlerësimi, vendimmarrja për karrierën etj. Ka botuar artikuj dhe dokumente hulumtuese mbi politikat arsimore, metodat mësimore, matjen dhe vlerësimin e nxënësit, arsimin profesional, si edhe tema të tjera që lidhen me orientimin profesional si edhe është autore e standartizimit të katër testeve të karrierës në Shqipëri. Fushat kryesore të ekspertizës janë: këshillim karriere, trajnimi i mësuesve, matja dhe vlerësimi në arsim, politikat arsimore, aftësitë e buta, menaxhimi i programeve të edukimit në shkallë të gjerë.

Është autore e publikimeve të ndryshme në fushën e arsimit dhe orientimit profesional, brenda dhe jashtë vendit.